



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

AMENDAMENTI 1 PËR KONTRATË TË PUNËVE

“Zgjerimi i rrugës Nëna Terezë” -Kontratë tri vjeçare

Numri i identifikimit – 632-19-096-521

E lidhur në Gjakovë, me dt.30.04.2020, në mes të:

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoritetit Kontraktues)
dhe

“Joos&Krasniqi- ” sh.p.k.- Junik, me nr.biznesit 810962309(në tekstin e mëtejme Kontraktuesi)

kanë rënë dakord si më poshtë:

Dispozitat e Kontratës “Zgjerimi i rrugës Nëna Terezë-Kontratë tri vjeçare, me nr. identifikimit – 632-19-096-521, të lidhur me dt.12.12.2019, ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit, zëvendësohet / plotësohet si më poshtë:

- Te Neni 1 LËNDA-paragrafet 1.3 dhe 1.6:

1.1“Kontrata do të nënshkruhet me dt.12.12.2019. Ky projekt do të kryhet brenda 3 viteve”;

1.6 “Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit prej 10% të vlerës së kontraktuar për 37 muaj; dhe

- Te Kushtet e Veçanta :

- Sigurimi i ekzekutimit –paragrafi 10.1:

“Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit prej 10% të vlerës së kontraktuar për 37 muaj”

- Fillimi i punëve - paragrafi 17.2 :

“Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 36 muaj”

Ne përputhje me nenin 61, paragrafët 61.22 dhe 61.23, të RRUOPP, paragrafët e lartcekur të kontratës “Zgjerimi i rrugës Nëna Terezë-Kontratë tri vjeçare, me nr. identifikimit – 632-19-096-521, e lidhur me dt.12.12.2019, ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit, ndryshohen me se vijon:

• **Te Neni 1 LËNDA :**

- Për paragrafin 1.3, palët kontraktuese pajtohen që projekti të kryhet për **90 ditë pune brenda vitit 2020, në vend të 3 viteve;**
- Për paragrafin 1.6, palët kontraktuese pajtohen që sigurimi i ekzekutimit prej **10% të vlerës së kontraktuar nga 37 muaj të zvogëlohet – vlejë për 13 muaj.**

• **Te Kushtet e Veçanta :**

- Për paragrafin 10.1 palët kontraktuese pajtohen që sigurimi i ekzekutimit prej **10% të vlerës së kontraktuar nga 37 muaj të zvogëlohet – vlejë për 13 muaj .**
- Për paragrafin 17.2, palët kontraktuese pajtohen që data e përfundimit e të gjitha punëve, të shkurtohet nga **36 muaj në 90 ditë pune brenda vitit 2020”.**


Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara. Ky amendament do të jetë pjesë përbërëse e kontratës dhe do të hyjë në fuqi në datën e mëvonshme të nënshkrimit nga palët.

Bërë në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues, dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	z.Faton Gutaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	30.04.2020
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Agron Krasniqi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	30.04.2020
Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË:	23.04.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Faton Gutaj, Menaxher i Prokurimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Shkumbin Kastrati
NGA/OD/FROM	Rexhë Rexha, menaxher i kontratës me titull: "Zgjerimi i rrugës Nena Terezë"
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shkurtrim të kohëzgjatjes të kontratës Zgjerimi i rrugës Nene Tereza

Përshëndetje,

Duke pasur parasysh se jemi në fillimin e punimeve të kontratës me titull: **Zgjerimi i rrugës Nena Terezë** – **Kontratë tri vjeçare** me nr. ident. 632-19-096-521 i lidhur me dt. 12.12.2019.

Nga Njësia Kërkuese është paraparë kryerja e punimeve me një kohëzgjatje prej 3 viteve, arsyeja ka qenë ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimit në rrugën Nëna Terezë. Punimet janë realizuar nga KWE – ja mirëpo gjatë vendosjes së kanalizimit është dëmtuar kjo rrugë në tërësi.

Unë Menaxher i kontratës bazuar në "**Rregullat edhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik**" tek pozicioni **Ndryshimi i Kontratës** pika 61.21 (Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës.), **kërkoj nga Ju** që të ta iniconi kërkesën time për shkurtrimin e kohëzgjatjes së kontratës nga 3 vite në 90 ditë pune për vitin 2020 .

Kërkesa e ime është për ndryshim të kontratës - shkurtrim të afatit kohor për realizimin e punimeve; gjegjësisht të bëhet përshpejtimi i procedurave **te ndryshohet plani dinamik**.

Me respekt.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Postal address: Nëna Tereze nr.469 Gjakovë-Kosovë, 50000

Tel: +381 390-320-050

kk.rks-gov.net/gjakove/



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	28.04.2020
REFERENC - E:	09/Zyrtare/2020
PER/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës Gjakovë, - z. Ardian Gjini
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Shërbime Publike, - Shkumbin Kastrati
CC:	z. Faton Gutaj – Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit z. Rexhe Rexha – Menaxher i Projektit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	KËRKESË

I nderuar Kryetar,

Përmes kësaj shkrese kërkoj aprovimin tuaj për lejimin e aneks kontratës me numër 632-19-096-521 me titull: “Zgjerimi i rrugës Nëna Tereza – Kontratë tri Vjeçare”.

Aneks kontrata do të përmban planin dinamik për kryerje të punimeve i cili, sipas planifikimit do të jetë 90 ditë dhe nuk do të ndryshoj nga kontrata bazë.

Me që kontrata e nënshkruar ka afat tri vjeçare, duke marrë parasysh se rruga në të cilën do të punohet është e rëndësishë së veçantë dhe si e tillë duhet të ketë punime në afatin sa më të shkurtër përkatësisht për 90 ditë brenda këtij viti, e jo për tri vite siç është e paraparë në kontratë.

Po ashtu ju njoftoj se kemi siguruar bartjen e mjeteve në kodin 22 (shuma: 200,000.00 €) për këtë aktivitet për vitin 2020. Për këtë aneks kemi biseduar edhe me kontraktuesin i cili është pajtuar në parim për këtë ndryshim në kontratë.

APROVOI:




Me Respekt,

REFUZOI:

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Postal address: Nëna Terezë, Nr. 469 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>